



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 4, DATË 16.01.2020

PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT, SHOQËRISË “DIGICOM” SH.P.K., PËR
PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE
MBËSHTETUR NË INTERNET (OTT) DHE KONSTATIMIN E
PAVLEFSHMËRISË SË AUTORIZIMIT PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË
PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË INTERNET
(IPTV)

Në mbështetje të nenit 55, pika 4/c dhe nenit 68/b të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 4400 prot., datë 13.12.2019, të shoqërisë “DIGICOM” sh.p.k., Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Dhënie e autorizimit, shoqërisë “DIGICOM” sh.p.k., me NIPT: L42018012R dhe administrator z. Thoma Zbogo, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (OTT) “DIGICOM”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Pranimin e kërkesës së subjektit dhe konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “DIGICOM” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV) “DIGICOM”.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA